

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Ilirjana Hoti, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit J. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publikë nga neni 378/9-6 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore –DP ne Gjakovë, PP/II-nr.861/16 të datës 18.08.2016, në shqyrtimin gjyqësor fillestar, të mbajtur më datë **25.08.2016**, në prani të Prokurorit të shtetit Mone Sylja, përf. ligjor te dëmtuarave K. P. dhe perf. te autorizuar av. T. B., të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij N. D., av. në Gjakovë, me dt. 26.08.2016 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **J. B.**, nga Gjakova, i lindur me dt..., ne Gjakovë, ku edhe tani jeton, i biri i N. dhe i nënës M. e gjinisë P., ka te kryer shkollën e mesme, kamerier, i gjendjes se varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i pa martuar.

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse:

-me datën 26.06.2016, rreth orës 15.30 min., ne rrugën magjistrale Gjakovë-Klinë, në fshatin Meqë-Komuna e Gjakovës, i akuzuari derisa po drejtonte automjetin e udhëtarëve të markës “Peugeot-307”, ngjyrë e zezë, me targa të regjistrimit me nr..., në kundërshtim me nenin 42 dhe 54 të Ligjit mbi Sigurinë e Komunikacionit Rrugor, nga pakujdesia edhe pse ka qene i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund te shkaktohet si rezultat i veprimit apo mos veprimit te tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do te shkaktohet ose do te parandalojë shkaktimin e saj dhe pasoja është shkaktuar ne atë mënyrë qe i akuzuari duke mos pasur kujdes te shtuar për pjesëmarrësit e tjerë ne komunikacion dhe duke mos respektuar kufizimin e shpejtësisë se lëvizjes e qe për atë pjese te rrugës ishte 80k/h (ndërsa shpejtësia e veturës “Peugeot 307”, ne piken e goditjes ka qene 90k/h), i akuzuari me te arritur ne dalje te fshatit Meqë –Komuna e Gjakovës, ne vend ku rruga ishte me kthesë, i akuzuari kalon nga ana e vete e djathtë e rrugës ne anën e majtë te rrugës (e destinuar për lëvizje te mjeteve nga kahja e kundërte) dhe me pjesën e përparme frontale te anës se majtë e godet ne pjesën anësore te anës se majtë automjetin e ud

hëtarëve te markës “Fiat Punto” ngjyre e zezë, me targ. Regj...,te cilën e drejtonte I.(K.) P.,e cila ne momentin kritik ishte ne lëvizje përballë –kalim dhe me te vërejtur rrezikun tenton te i shmanget aksidentit, por për shkak te distancës dhe intervalit te shkurtër kohorë nuk arrin qe ta evitojë aksidentin, me ç’rast nga inercioni i goditjes automjeti “Fiat Punto” del jashtë rruge duke u përplasur fillimisht ne rrethojat e metalta –mbrojtësit e rrugës ne anën e djathtë ne drejtim te lëvizjes dhe pastaj hedhet duke u rrokullisur poshtë ne fushë, ku si pasoj e këtij aksidenti shkaktohen dëme te konsiderueshme materiale ne te dy automjetet dhe nga lëndimet e renda trupore humbin jetën drejtuesja e automjetit “Fiat Punto” I. P., sipas Raportit te Autopsisë nr.MA16-147 e Dr. N. H. ,dt.18.08.2016 dhe bashkudhëtarja –motra e saj D. P. sipas Raportit te Autopsisë nr. MA16-146 te Dr. N. H. dt. 18.08.2016, ndërsa lëndime te lehta trupore me pasoja te përkohshme për shëndetin marrin i akuzuari J. B., M. B. dhe T. Xh., te përshkruar me për afërsisht si ne akt-ekspertimin mjeko ligjor te Dr. F. B. te dt.16.08.2016.

- me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378/9-6 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në baze te nenit 4,7,17, 41,45,73,74,75,83, 378/9-6 te KPRK-së dhe nenit 365 te KPPK-së, te akuzuarin:

E G J Y K O N

Dënim burgu ne kohëzgjatje prej **2(dy) viteve**, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt.26.06.2016 e tutje.

Të dëmtuarit, Perf. ligjor i palëve te dëmtuara K. P.,T. Xh. dhe M. B., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari qe ne emër të shpenzimeve procedurale- ekspertizës se komunikacionit dhe mjeko ligjore te paguaj shumen prej **132.00 €** dhe ne emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumën prej **30.00 euro**, ne afatin prej **15 ditëve**, pasi qe Aktgjykimi te merre formë te prerë, nen kërcënim te përmbarimit me dhunë

A r s y e t i m

Prokuroria e Themelore –DP ne Gjakovë, ka ngritë Aktakuzën PP/II.nr.861/16 të 18.08.16, ndaj të akuzuarit J. B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378/9-6 të KPK-ës si dhe përmes parashtrësës PP/II nr. 861/16 për plotësimin e aktakuzës dt. 22.08.2016, me te cilën kërkon vazhdimin e masës se paraburgimit deri ne plotfuqishmërinë e aktgjykimit, duke propozuar qe i akuzuari te shpallet fajtor, te dënohet sipas ligjit dhe te obligohet ne pagesën e shpenzimeve procedurale.

Gjatë shqyrtimit fillestar të datës 25.08.2016, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë, Prokurori Mone Sylja, mbetet ne tërësi pran aktakuzës si dhe plotësimi te aktakuzës te dt. 22.08.2016 për vazhdimin e paraburgimit deri ne plotfuqishmëri te aktgjykimit. Në fjalën përfundimtare deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit, dhe deklaroi se aktakuza ka mbështetjen e plote ligjore duke u mbështetur ne provat te cilat janë te prezantuara ne lende, andaj kërkohet qe i akuzuari te shpallet fajtor te dënohet sipas ligjit dhe te obligohet ne pagesën e shpenzimeve procedurale

Perf. I autorizuar av. T. B. i perf. Ligjore K. P., ne fjalën përfundimtare deklaroi se mendojë se pranimi i fajësisë bazuar ne dispozitat e KPRK-ës, krijon bene fite për te akuzuarin por ne rastin e caktimit te lartësisë se sanksionit penal kjo gjykatë te këtë parasysh faktin se si është zhvilluar aksidenti e cila me saktësisht është pasqyruar ne ekspertizën komunikacionit te ekspertit Y. K., si dhe pasojat jashtëzakonisht te renda për familjen e dëmtuar te cilët ne këtë aksident kanë humbur dy anëtar te familjes te moshës se re, andaj i propozoi gjykatës qe te këtë parasysh te gjitha rrethanat e caktuara me ligj dhe se vërtet është fakt se vepra është kryer pa dashje se i akuzuari ka shpreh pendës, por te kihen parasysh edhe pasojat veçanërisht te renda. Përndryshe i bashkëngjitet ne tërësi fjalës përfundimtare dhe pretendimeve te prokurores se çështjes.

Perf. i ligjor i te dëmtuarave e– babai, K. P. e mbështete ne tërësi fjalën përfundimtare te perf. Te autorizuar av. T. B. dhe deklaroi se i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe kërkon kompensim demi e cila do te realizohet ne kontest civil.

E dëmtuara M. B. deklaroi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim demi .

I akuzuari J. B., gjate shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë, thekson se pas konsultimit me mbrojtësin av. N. D. e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion

Mbrojtësi i te akuzuarit av. N. D. ne fjalën përfundimtare deklaroi edhe njëherë ne emër te pandehurit shprehi keqardhje pe atë qe ka ndodhur nga familjaret e te dëmtuarave si dhe i falënderojë për mirëkuptimin qe kanë pasur se ne raportet private mes tyre nuk kanë pasur raporte te acaruar, i pandehuri gjate këtij

shqyrtimi e ka pranuar fajësinë, ashtu që faktet nga aktakuza nuk janë kontestuese, ndoshta një pranim të tillë të fajësisë do ta kishin bere edhe në fazën e hetimeve sikur të kishin pasur faktet dhe provat në shkresat e lendes, ashtu që gjykatës nuk i mbetet tjetër vetëm të përcaktohet për llojin dhe lartësinë e dënimit. Në jemi të vetëdijshme për pasojat e veprës ku janë të pa kompensueshme, me gjithësie nëse i referohemi anës ligjore në si mbrojtje mendojmë se gjykata në rastin konkret gjendet pranë shume rrethanave lehtësuese siç janë pendimi i thellë, pranimi i veprës, rrethanat tjera që i përshkruhen personalitetit të kryesit, kemi të bëjmë me një kryes që nuk është recidivist, nuk ka asnjë evidencë për kryerje të veprave nga lemia e komunikacionit, ditën koritke ka qene duke zhvilluar shpejtësi krejt normale me ndryshimin e shpejtësisë se lejuar dhe tejkalimi i shpejtësisë është diku 10k/h, dhe me vete faktin e drejtimit të një automjeti që është mjet i rrezikshëm pavarësisht disiplinës dhe kujdesit që ka ngasësi i automjetit janë të mundshme pasojat, dhe ligjdhënësi i ka trajtuar si vepra të kryera nga pakujdesia dhe se ka rrezikuar anëtarët e vete të familjes dhe veten, andaj konsiderojë se ka rrethana lehtësuese se mundë të shqiptohet një dënim në kuadër të minimumit ligjor apo dënim edhe me të butë. Në dëgjomë se prokuroria me një parashtresë shtesë ka kërkuar të vazhdohet paraburgimi dhe paraburgimin e ka mbështetur vetëm se ekziston dyshimi i bazuar, mendojë se në rastin konkret nuk ka vend për vazhdim të paraburgimit se i pandehuri e ka pranuar fajësinë nuk e ka kundërshtuar asnjë fakt dhe natyra e këtyre veprave penale i ka lejuar edhe gjykata që këto raste ose ndërprehet paraburgimi gjate hetimeve apo gjate shqyrtimeve, propozojë që të ndërprehet masa e paraburgimi.

I akuzuari J. B., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e mbështet në tersi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij njëherë kërkon falje para të perf. ligjor i të dëmtuarave dhe të dëmtuarës e cila nuk është e pranishme.

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale që i vihat në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av. N. D. në Gjakovë, e pranimi i fajësisë mbështetet edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 të KPPK-së, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Gjykata ka konstatuar se i akuzuari J. B., ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 42 dhe 54 të Ligjit për Siguri në Komunikacionin Rrugor, duke drejtuar automjetin e makinës “Peugeot”, ngjyre e zezë, me targ. regj..., ku nga pakujdesia duke mos pasur kujdes të shtuar për pjesëmarrësit tjetër në komunikacion dhe duke mos respektuar kufizimin e shpejtësisë se lëvizjes e që për atë pjesë të rrugës ishte 80k/h, me të arritur në dalje të fsh. Meqe K Gjakovë, i akuzuari kalon nga ana e vet e djathtë e rrugës në anën e majtë të rrugës dhe me pjesën e përparmë frontale të anës së majtë e godet në pjesën anësore të anës së majtë automjetin e udhëtareve të markës “Fiat Punto” ngjyre e zezë, me tar. regj..., të cilën e drejtonte I. K. P. e cila në momentin kritik ishte në lëvizje përballë –kalim dhe me të vërejtur rrezikun tenton të i shmangët aksidentit, por për shkak të distancës dhe intervalit të shkurtër kohorë nuk arrin që ta evitojë aksidentin, me ç’rast nga inercioni i goditjes automjeti “Fiat Punto” del jashtë rrugë duke u përplasur fillimisht në rrethojat e metalta – mbrojtësit e rrugës në anën e djathtë në drejtim të lëvizjes dhe pastaj hedhet duke u rrokullisur poshtë në fushë, ku si pasojë e këtij aksidenti shkaktohen dëme të konsiderueshme materiale në të dy automjetet dhe nga lëndimet e rëndë trupore humbin jetën drejtuesja e automjetit “Fiat Punto” I. P. sipas Raportit të Autopsisë nr.MA16-147 e Dr. N. H. ,dt.18.08.2016 dhe bashkudhëtarja –motra e saj D. P. sipas Raportit të Autopsisë nr. MA16-146 të Dr. N. H. dt.18.08.2016, ndërsa lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin marrin i akuzuari J. B., M. B. dhe T. Xh., të përshkruar me përfaqësisht si në akt-ekspertimin mjeko ligjor të Dr. F. B. të dt.16.08.2016, me çka ka kryer veprën penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 378/9-6 të KPRK-ës.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese gjykata e

konsideroi faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale te rrezikimit te trafikut publik nga neni 378 par.9-6 të KPRK-ës, përkatësisht shkaktimi i aksidentit me fatalitet, vdekja e dy personave të moshës së re ne komunikacion si dhe e dy personave tjerë me lëndime të lehta trupore, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykatë, shprehjen e keqardhjes familjareve të dëmtuarit, pendimin e tij për veprimin e bere nga pakujdesia, faktin se i akuzuari me pare nuk ka qene i dënuar, si dhe gjendjen e varfër ekonomike. Në këtë drejtim ka ndikuar veçanërisht personaliteti i tij, që te Gjykata është kuptuar si njeri i sjellshëm, korrekt, i urtë dhe i vetëdijshëm për pasojat e shkaktuara. Si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata e vlerësoi pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar si dhe gjendjen emocionale të tij nga momenti i shkaktimit të aksidentit, të cilat rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 75 të KPRK-së, Gjykata të akuzuarin e gjykon me dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 2(dy) viteve, e në te cilën dënim duhet ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt. 26.06.2016, me bindje se edhe me këtë dënim do te arrihet qëllimi i dënimit dhe se ky dënim i shqiptuar sipas bindjes se gjykatës është ne proporcion me veprën penale te kryer dhe me rrethanat personale te cilat i posedon i akuzuari, i paraparë nga neni 41 te KPRK-ës.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike u bazua në nenin 463 par.2 te KPPK-së.

Vendimi që të akuzuarit J. B., ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim si në dispozitivë të këtij Aktgjykimi u muar në bazë të nenit 83 par.1të KPRK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën parag 2.1dhe 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.482/16 më dt. 26.08.2016.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**G j y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes se tij në dorëzim, Gjykatës se Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.